



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 20.06.2022, Nr. 09-MI/01-28939



Në bazë të nenit 64 pika 1, 67 dhe 68 e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë të Republikës së Kosovës, në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Komuna e Drenasit (Glllogoc), shpall:

KONKURS

1. Titulli i pozitës së punës: Mësimdhënës/e

1. SHFMU „Abedin Bujupi ” në Arllat.

- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, me 17 orë (8 orë në SHFMU „Abedin Bujupi ”- Arllat, 5 orë në SHFMU”Jusuf Gërvalla”-Negroc, 4 orë në “M.S.Bytyqi”-Bytyq), me kohë të pacaktuar.

2. SHFMU „Shotë Galica ” në Abri e Epërme.

- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, me 17 orë (8 orë në SHFMU „ Shotë Galica ” në Abri e Epërme , 5 orë në SHFMU”Migjeni”-Baicë dhe 4 orë në SHFMU “Gani Elshani”- Kroikovë), me kohë të pacaktuar.

3. SHFMU „Rasim Këçina ” në Drenas.

- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, me 20 orë, (15 orë në SHFMU „Rasim Këçina ” në Drenas dhe 5 orë në SHFMU “Naim Frashëri”-Glllobar), me kohë të pacaktuar.

4. SHFMU „ Hasan Prishtina ” në Llapushnik.

- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, me 19 orë (8 orë në SHFMU „ Hasan Prishtina ” në Llapushnik, 7 orë në SHFMU”Halil Bajraktari”-Drenas II, dhe 4 orë në SHFMU “ Fazli Grejçevci”-Vasilevë), me kohë të pacaktuar.

5. SHFMU „ Ali Gashi ” në Çikatovë e Re.

- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU „ Ali Gashi ” në Çikatovë e Re , 4 orë në SHFMU”Azem Bejta”-Shtuticë,4 orë në SHFMU “Dëshmoret e Fortesës”-Verboc, dhe 4 orë në SHFMU “Shaban Polluzha” - Polluzhë), me kohë të pacaktuar.

6. SHFMU „ 7 Marsi ” në Kishnarekë.

- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, me 16 orë (8 orë në SHFMU “ Fehmi dhe Islam Kastrati ” në Kishnarekë, 8 orë në SHFMU”Bajram Curri”-Nekoc), me kohë të pacaktuar.

7. SHFMU „ Xheladin Gashi-Plaku ” në Komaran.

- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, me 20 orë (8 orë në SHFMU „ Xheladin Gashi-Plaku ” në Komaran , 8 orë në SHFMU”Luigj Gurakuqi”-Sankoc,dhe 4 orë në SHFMU “24 Korriku”- Fushticë e Poshtme), me kohë të pacaktuar.

8. SHFMU „ Arif Shala ” në Korroticë e Poshtme.

- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, me 18 orë (5 orë në SHFMU “Arif Shala”- Korroticë e Poshtme, 5 orë në SHFMU”Shaban Polluzha”-Korroticë e Epërme, 4 orë në SHFMU “Dëshmorët e Qëndresës II” – Tërstenik dhe 4 orë në SHFMU” Zenel Hajdini” në Tërstenik), me kohë të pacaktuar.

9. SHMP” Fehmi Lladrovci”- Drenas

- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, me kohë të pacaktuar.
- 10. SHML”GJ.K.Skënderbeu”-Drenas.**
- Një mësimdhënës/e Gjuhë Gjermane, deri sa të kthehet mësimdhënësi prej funksionit zyrtar.
- 11. SHFMU” Zenel Hajdini” – Tërstenik**
- Një mësimdhënës/e për Matematikë, deri më 31.08.2023(më mundësi vazhdimi),
- 12. SHFMU” Shaban Polluzha “ – Korroticë e Epërme**
- Një mësimdhënës/e Edukatë Muzikore – deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.
- 13. SHFMU” Regjep Gjeli” – Likoshan**
- Një mësimdhënës/e për Matematikë– deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.
- 14. SHFMU” Shaban Polluzha ” – Polluzhë.**
- Një mësimdhënës/e Gjuhë Shqipe – deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.
- Një mësimdhënës/e Gjuhë Angleze – deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.
- 15. SHFMU” Dëshmoret e Fortesës ” – Vërboc.**
- Një mësimdhënës/e Fizikë – deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.

1.1. Detyrat dhe përgjegjësitë: Mesimdhënësit/es

1. Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës.
1. Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
2. Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
3. Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon.
4. Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktojë ai/a jo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
5. Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së.
6. Të mos e shfrytëzoi pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.
7. Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhën me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave sipas kësaj kontrate apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.
8. Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
9. I punësuari është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.
10. I punësuari sipas kësaj kontrate, nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit të saj.
11. Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Institucioni: Komuna e Drenasit

Drejtoria: Drejtoria për Arsim
Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik
Numri i Pozitave: (15) Pesëmbdhjetë
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Shkollës

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vëndet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.05/2021-MASHTI.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik (vula orgjinale, jo në kopje).
4. Çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
5. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur më çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim, me gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do të bëjë Komisioni i përzgjedhur nga Drejtoria për Arsim në Drenas.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-s,të plotësohet rrjedhshëm në Gjuhën Shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentët e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shtesë jashtë afatit të dorëzimit në arkiv nuk pranohen, dhe dukumentacionet e dorëzuara për aplikim nuk kthehen.

AFATI DHE MËNYRA E APLIKIMIT:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 20.07.2022 deri 03.08.2022.

Njoftimet dhe rezultatet shpallen në web faqen zyrtare të Komunës së Drenasit dhe në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net>.

Drenas,
Më:20.06.2022

